

URDHËR
Nr. 553, datë 31.8.2021

PËR MOSRIPËRTËRITJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AGJENCIA E MBROJTJES SË PRODUCENTËVE ‘AMP’” PËR ADMINISTRIMIN KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE DHE TË PRODHUESVE TË FIKSIMEVE TË PARA TË FILMAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 134, 135, 157 dhe 158, të ligjit nr. 35/2016, “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, të udhëzimit nr. 385, datë 13.10.2020, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për marrjen e licencës për administrimin kolektiv të të drejtave të autorit, ripërtëritjen e saj, si dhe përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pezullimin dhe heqjen e licencës, në zbatim të ligjit nr. 35/2016, datë 31.3.2016, ‘Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to’”, të ndryshuar, të kërkesës së shoqërisë “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve ‘AMP’” nr. 3696 prot., datë 16.7.2021, “Për ripërtëritjen e licencës si agjenci e administrimit kolektiv, për kategorinë e të drejtave të prodhuesve të fonogramit dhe të prodhuesve të fiksimeve të para të filmave”, si dhe të legjislacionit në fuqi “Për organizatat jofitimprurëse”,

URDHËROJ:

1. Mosripërtëritjen e licencës për shoqërinë “Agjencia e Mbrojtjes së Producentëve ‘AMP’” në administrimin kolektiv të të drejtave të prodhuesve të fonogramit dhe të prodhuesve të fiksimeve të para të filmave.
 2. Ngarkohet Drejtoria e së Drejtës së Autorit për njoftimin e këtij urdhri.
 3. Kundër këtij urdhri, kërkuesi ka të drejtën e ankimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS
Elva Margariti